



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 704/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.569/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji “UBT” për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.585/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.585/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji UBT, dega në Ferizaj:
 - Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS (me specializime: Projektim; Planifikim Urban dhe Hapsinor), dhe
 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Rrjeta dhe Telekomunikacion; Softuer dhe Sistemet Inxhinierie; Bazat e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit; Dizajn dhe Multimedia; Mekatronikë dhe Robotikë).
- III. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.585/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji UBT, dega në Prizren:
 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Rrjeta dhe Telekomunikacion; Softuer dhe Sistemet Inxhinierie; Bazat e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit; Dizajn dhe Multimedia; Mekatronikë dhe Robotikë).
- IV. Lejohet regjistrimi i studenteve në programin e cekura në pikën dy dhe tre të këtij vendimi.
- V. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.585/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji UBT me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 585/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegji UBT i është pezulluar akreditimi për programet e studimit: Kampusin në Prishtinë: Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS; E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane e Biznesit, LLM, 60 ECTS, dhe Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS. Dega në Prizren: Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS, dhe Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS. Dega në Ferizaj: Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS, dhe Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji UBT, është konstatuar që programet e cekura në pikën dy dhe tre të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.585/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "UBT";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

